



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

Komuna -Klinë

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi

Nr. 0~~60~~-42561 2022

Data: 07.07.2022

21.07.2022

#### PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, e mbajtur më 07.07.2022 në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar nga ora 16:00.

Zv. Kryesuesja znj. Marqe Selmanaj përshendetetë gjithë të pranishmit.

Zv. Kryesuesja znj. Marqe Selmanaj: Ateherë përshendetje për të gjithë, pak po më duket që temperaturat koxha të larta e të mos humbim kohë. Sa po e shoh, ka që mungojnë megjithatë pjesa më e madhe janë këtu, atehërë përshendetje për të gjithë. Përshendetje për Komandatin, Drejtoreni, të gjithë përfaqësuesit fetarë, KFOR-in, FSK-në dhe të gjithë ju të pranishmit, uroj që këtë kohë së bashku të kalojmë sa më mirë dhe të shtjellojmë temat për të cilat jemi mbledhur këtu.

Thash edhe një herë sa i përket numrit të pjesëmarrësve, është shumë më i zvogëluar se sa herave tjera, kështu që më këta që kemi mbetur, besojë që do të vazhdojmë deri në fund.

Zv. Kryesuesja znj. Marqe Selmanaj, prezantoj rëndin e ditës:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
3. Siguria në shkollat fillore dhe në ato të mesme (parapërgatitje për Shtator),
4. Sensibilizimi i të rinjëve përmbrrojtje nga dukuritë negative,
5. Të ndryshme.

1. Arsyetimi i mungesave.

Zv. Kryesuesja znj. Marqe Selmanaj theksoj se shumica e anetarëve janë prezent, që nuk ka ndonjë person që ka lajmëruar përmbrrojtje nga dukuritë negative, por sido që të jetë sigurisht që



kanë pasur arsyet e tyre.

## 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Zv. Kryesuesja znj. Marqe Selmanaj: Më u ndal dhe më ju pyet për procesverbalin e mbledhjes së kaluar nuk kemi mjaftueshëm kohë që më mujt më u ndal më i analizu në detaje dhe nëse e mendoni njësoj edhe ju, e kishim kalu si të rregulltë dhe herave të tjera do të kemi mundësi që në kohë ta shpërndajmë në email-et e juaja.

Anetarët u pajtuan që të kalohet i rregulltë dhe Zv. Kryesuesja znj. Marqe Selmanaj kaloj në pikën e tretë të rëndit të ditës.

## 3. Siguria në shkollat fillore dhe ato të mesme (parapërgatitje për Shtator).

Zv. Kryesuesja znj. Marqe Selmanaj: Të gjitha këto tema të rëndit të ditës, ne i kemi marrë nga plani i përgjithshëm të cilin e kemi miratuar në Kuvend dhe e kemi shpërndarë të çdo njëri nga ju, në takimin e kaluar dhe duke u bazuar në temat që i kemi paraparë për një vit, ju jeni pjesa më e madhe e anëtarëve që keni qënë edhe në vitet e kaluara dhe jam shumë e sigurt që e dini që tema kryesore është siguria në komunën e Klinës. Gjatë tërë vitit, janë 6 takime në bazë të planit që e kemi paraparë, jemi munduar që këto ti ndajmë në 6 mënyra që t'a shtjellojmë sa më mirë planin që e kemi të miratuar.

Tash nuk e dimë se sa do të mund të jemi koherent më planin, mirëpo do të mundohemi.

Tema e parë është siguria në shkolla. Është një temë për të cilën ndoshta është herët të flasim për fillimin e viti shkollor, mirëpo e dimë që KKSBB-ja si takim i ka çdo 2 muaj dhe pikërisht kjo është koha që neve na nevojitet që të kemi një plan, së çfarë duhet të bëjmë që të jemi më të sigurt dhe më të përgaditur për fillimin e viti shkollor. Këtu sipas rregullorës, e kemi të pranishëm edhe Drejtorinë e Arsimit dhe nëse ka diçka për të shtuar sigurisht që do të jetë i gatshëm të përgjigjet. Pra sipas objektivave, është siguria në shkolla fillore dhe të mesme dhe si aktivitet e kemi mirëmbajtjen e qëndrës monitoruese, kamerave dhe rrjeteve të cilat veç kanë filluar dhe nuk është diçka që po e fillojmë vetëm tani. E kemi filluar që nga viti i kaluar që në të gjitha shkollat të këtë kamera të sigurisë mirëpo nuk është që gjithçka ka përfunduar, besojë që shumë shpejtë do të jemi të gatshëm që çdo shkollë të këtë sigurinë sa i përket kamerave, pjesa tjetër është vendosja e shkallëve emergjente që është e paraparë, realizimi i kamerave dhe vendosja e shkallëve emergjente është e mbështetur nga Drejtoria e Urbanizmit.

Kuptohet që kemi një bashkëpunim të mirë më Drejtorinë e Arsimit, por gjithashtu edhe më Policinë në nivel të Komunës, që është i paraparë gjatë tërë vitit shkollor, unë duke e pasur një praktikë të mirë si mësimdhënëse dhe drejtoreshë shkolle kemi pasur një bashkëpunim shumë të mirë më Policinë, gjithmonë kanë qëndruar afér shkollave mirëpo është edhe një problem tjetër kur flasim për sigurinë, ka të bëj edhe më sigurinë në trafik, pjesa më e madhe e shkollave që janë afér rrugës ju mungojnë shtresat e rrugëve që duhet të vendosën që të ngadalësohet vozitja, kjo është edhe në proces të menaxhimit nga projektet që i ka bërë Komuna, të cilat shumë shpejtë do të realizohen.

Nëse ndokush ka diçka për të diskutuar këtu jemi të kompletuar dhe të gatshëm për çdo gjë.

Z. Agim Qerkinaj: Deshta të bëj një pyetje pikërisht me rrugë, në lidhje më Kishën Katolike në komunën e Klinës, çështja është përfëmijët, e kam verejtur së aty zhvillohet një shpejtësi enorme dhe çështja është a mund të vendosën shiritat në atë pozitën para hyrjes së Kishës dhe mbrapa së paku disa shirita që më e ba më dije se aty është një vend ku frekuentohet nga shumë fëmijë. Ka pasur raste ku është shkel



fëmija nga një kamion para disa viteve dhe mendojë që është shumë e nevojshme që të mund të bëhet sepse kam dëshirë që fëmijët të jenë sa më të sigurtë.

Zv. Kryesuesja znj. Marqe Selmanaj: Faleminderit Don Agim, para se të jap përgjigje, unë ndoshta e anashkalova rëndin e ditës dhe nuk pyeta për aprovimin e juaj kështu që duhet të kthehem edhe njëherë në fillim, e aproponi rëndin e ditës apo ka dikush diçka për të shtuar.

Anëtarët e ngritën dorën për aprovimin e rëndit të ditës.

Zv. Kryesuesja znj. Marqe Selmanaj: Faleminderit shumë, unë thashë që ndoshta duhet të ndërlidhemi edhe më të tjerët më herët por në strategjinë e planifikimit buxhetor dhe projekteve që priten të realizohen në komunën e Klinës, është e paraparë edhe kjo mënyre e sigurisë së fëmijëve, të moshuarëve dhe kush do që e frekuenton rrugën. Këto praktika janë shumë të herëshme që fëmijët tanë janë rrëzuar në zona të ndryshme, mirëpo janë disa zona që nuk lejohen për shkak të specifikave të udhëtimit që të krijohen ato ndalesa, nëse më kishte ndihmuar komandanti i Policisë të na e sqaroj se ku janë këto të lejueshme që të vendosën sepse unë e di që në një vend ku e kemi kërkuar para 7 viteve, nuk më është lejuar edhe pse i kam bërë 2-3 kërkesa, në atë zonë thuhet që është një rrugë që frekuentohet shumë etj e që nuk mund të lejohet kështu që t'ia japim fjalën komandatit.

Komandanti i Policisë z. Ragip Bytyqi: Përshendetje për të gjithë, sa i përket pyetjes është hera e parë që unë dëgjoj që kërkohet kjo sepse në patrullat tona të Policisë, në bazë ditore e planifikojmë në atë zonë edhe përdorimin e radarit. Si qytetarë e keni verejtur që shqyrtojmë gjoba rreth parandalimit të aksidenteve dhe kam dëgjuar se një aksident ka qenë në atë rrugë më herët, mirëpo për shiritat në zonën e shpejtësisë në rrugë regionale duhet të kërkojmë për një aprovim për t'i vendosur, përndryshe ne aty ku ka rrezik i ndërmarrim masat dhe besojë që këtë shqetësim tuajin kemi për ta dërguar për shqyrtim që ta zgjidhim si problem dhe besojë që në takimin e radhës, herën tjetër kjo do të jetë temë e përfunduar.

Z. Josip Dedaj: Faleminderit zonja Nënkyetare, unë veç deshta më ndërhy këtu tek Don Agim Qerkinaj, vitin e kaluar unë e kam propozu gjithashtu kërkësën e tij dhe ka qenë Kryetari dhe Komandati që kanë deklaruar që duhet t'i vendosim shiritat edhe që shpejtësia lëvizëse të jetë së paku 40km\h mirëpo nuk është ndërmarrë asnjë gjë prej atëherë, do të thotë mund të them që është edhe procesverbali që e kemi thënë por për këtë duhet më i'a lënë komunës qka është bërë, ne kemi thënë disa herë që aty nuk është bërë një aksident, aty ka pas shumë aksidente edhe më fatalitete pikërisht para rrugës që kthehet për tek Kisha dhe të gjithë anëtarët kanë qenë këtu kur e kam propozuar në emër të Don Agim Qerkinaj që atë ditë nuk ka qenë prezent, kjo është e vertetë në muajin Nëntor apo Dhjetor kur e kemi pasur takimin e fundit unë këtë e kam vetëm arsyetim se kjo çka e thotë Don Agimi e kemi propozu para 7-8 muajve, mirëpo unë e kam pas edhe një propozim, unë jam anëtar këtu në këtë Këshill të Sigurisë në Bashkësi që 12 vite dhe çdo gjë që ne e kemi propozuar, anëtarët e Kuvendit Komunal as në qeverisjen e mëparshme as në këtë qeverisje do të thotë që nuk është fjala vetëm për këtë qeverisje aktuale por edhe të qeverisjes së PDK-së e që këtu ka shumë anëtarë që kemi qenë bashkë dhe nuk është bërë asnjë vendim që e kemi marrë ne, më përjashtim po më duket që i kemi parandaluar shitjen e mjeteve piroteknicke para festave të fundvitit e që do të thotë asnjë gjë që nuk është realizuar. Unë vetëm edhe një gjë dëshiroj më e cekë këtu për shenja të komunikacionit, që 10 vite jam duke e thënë këtë gjë, që 6-



7 vjet është i ndreq sheshi i Klinës e që janë dhënë 1 milion e 7,000€ e që shenja të komunikacionit nuk ka, e din edhe Komandanti që e kemi fol edhe në takimin e fundit këtu dhe kemi vendosë bashkë më Kryetarin Elezaj, që nuk ka shenja të përparesisë së kalimit, që është fatalitet për banorët e Klinës dhe pikërisht tek rrethi "Nue Perlleshi" ka pasur aksidente më fatalitet dhe në vendkalim të këmbësorëve nuk ka pasur shenja e që këto pasoja duhet të i bartë Komuna e Klinës dhe jo shoferi e këmbësori për shkak të mungesës së shenjës së komunikacionit, unë nuk e di më të vërtetë jam shumë i zhgënjyer edhe në qeverisjet e mëparëshme, kur nuk ka qenë Komandanti aktual i stacionit të Policisë, kanë qenë të tjerë dhe kështu këtë problem më shenja të komunikacionit vazhdojmë ta kemi që sa vite e sidomos prej që është rregulluar sheshi i Klinës e që janë dhënë kaq shumë të holla për të, faleminderit.

Zv. Kryesuesja znj. Marqe Selmanaj: Faleminderit Josip, më sa e pash të falenderojë njëherë për ndërhyrjen dhe kjo që ju e thatë nuk besojë që është krejt jashtë asaj që keni fol sepse është e paraparë në këtë plan, është e paraparë siguria në shkolla dhe sa i përketë sigurisë në komunikacion parashihet edhe siguria e nxënësve në trafik, mirëmbajtja e qëndrës monitoruese, kamerave dhe rrjeteve që do të thotë që të gjitha këto që i përmendëm edhe më herët si dhe kërkesa tjetër që e keni thënë për shtrimin e shiritave që zvogëlojnë shpejtësinë, ju e dini që 2 vite faktikisht nuk është arsyetim përderisa ndodhë diçka më fatalitet mirëpo e dimë që 2 vitet e fundit çdo projekt që është ndërmarrë të zhvillohet është stagnuar, e dini shumë mirë, nën 1 është arsyaja e pandemisë që fatkeqësisht në mënyrë graduale ka filluar të kthehet prapë, mandej problemet ekonomike globale jo vetëm në nivel vendi por edhe në nivel Komune dhe më gjerë, e të gjitha këto kanë bërë që shumë projekte të stagnojnë dhe mos të avansojmë më tutje, megjithatë përderisa e kemi paraparë si KKSBB, bashkërisht sepse kjo mënyrë e diskutimit na bënë të përgjegjshëm dhe na bënë së paku më trokit dhe më punu aty ku duhet dhe jam shumë e sigurtë se nëse na lejohet mënyra që e thashë më herët në aspektin profesional të asaj natyre që spo arrijë as të shprehem se cila është ajo mënyrë dhe ajo rrugë se ku ndalohet vendosja e atyre shiritave mirëpo nëse na lejohet, ne jo vetëm në atë pjesë ku e permendi Don Agimi po edhe në pjesët tjera ku janë edhe nxënësit megjithëse këtu tek shkolla "Ismet Raci" ka diçka që ka fillu, unë nuk e kisha thënë rastësisht por që e kam dëgju Kryetarin dhe e kam parë interesin e tij bashkë më drejtorinë përkatëse që e kanë diskutu në lidhje më këtë problem që e ngritëm së bashku, fillimisht e përdora si pjesë të Sigurisë së KKSBB-së po edhe që e morëm miratimin që jam shumë e sigurt që ky plan që është sot nuk është që unë e kam ndryshu 100% sepse siguria në një Komunë nuk është që ndryshon, është siguria në komunikacion, siguria e nxënësave, siguria ndaj dukurive negative dhe siguria mbetet siguri në çdo rrethanë, në çdo pushtet dhe në çdo kohë. Kjo mua më bënë shumë vigilente dhe na bënë më u merr më rastin, faleminderit shumë Josip.

Nëse ka dikush diçka për të shtuar.

Komandanti i Policisë z.Ragip Bytyqi: Sa i përket shiritave vibrues që the vitin e kaluar, mua personalisht nuk po më kujtohet që e kemi diskutuar diçka të tillë mirëpo sa i përket sinjalizimit, ne muaj më herët i kemi marr disa veprime, disa shenja që i kemi vendosë për shkak të tenderit nëse nuk gaboj muajin e kaluar veç ka përfunduar kjo çështje, nuk është që dëshiroj më arsyetu Komunën në asnje mënyrë sepse si po kërkon ju edhe ne në vazhdimësi kemi bërë kérkesë për t'i ndryshuar shenjat e komunikacionit aty ku ka nevojë dhe për këtë çështje kemi biseduar edhe më juve, që do të formojmë një ekip punues ku në mesin e ekipeve do të jenë disa inxhinierë të komunikacionit që jeni ju dhe krejt kjo është neglizhuar sepse kompania e cila është dashur t'i kryejë këto punime, nuk ka pas tender dmth nuk ka qenë tenderi aktiv dhe muajin e kaluar kam informacione që është rregulluar kjo çështje dhe besojë që shumë shpejt



kemi më dal më një ekip punues dhe më një projekt propozim të përbashkët, dhe normal që ka për të i'u dorëzu Kuvendit Komunal të Klinës, ka për t'u miratuar dhe kompania që e ka tenderin mbetet për të i ekzekutuar. Unë besojë që edhe në të kaluarën kur ju keni cekë diçka për të ndryshuar, ne e kemi realizuar atë, spo largohem shumë po ndalem tek siguria në shkolla, vitin e parë që kam ardhur është kërkuar për tek shkolla "Ismet Rraci" ku një numër i madh i nxënësve prej orës 12:00 – 13:00 në bazë ditore ju veç i keni parë aty patrullat që i siguron fëmijët për kalimin e rrugës.

Z.Don Agim Qerkinaj: Kërkoj falje, më shumë respekt Komandant, sepse keni të drejtë për kërkesën që e kam bërë, ka qenë Komandanti para jush që ka marrë pjesë në këto takime.

Zv. Kryesuesja znj.Marqe Selmanaj: Faleminderit Don Agim, nëse ka dikush tjetër diçka në lidhje më temën. Po Josip.

Z.Josip Dedaj: Vetëm edhe një përmirësim zotëri Komandant dhe zonja Kryesuese, kur të bëhet fjalë për çështjen e sigurisë në komunikacion, do të thotë unë lancohem pak nga siguria e shkollës për qka jemi duke biseduar për komunikacionin, duhet më thënë për të gjithë qytetarët e Klinës e jo vetëm për nxënësa, atë për qka kemi fol për Don Agim Qerkinaj, unë e kam propozuar në emër të tij dhe e din shumë mirë Kryetari edhe Nënkyetari që ka qenë, po dojmë mu largu se dojmë me punu për ta, herën e kaluar kemi biseduar për shenja të komunikacionit, rruga prej shkollës "Luigj Gurakuqi" në drejtim të lagjës së Sefer Manve nuk ka shenjë që është njëkahëshe zotëri Komandant, policët e stacionit tanë kanë dhënë tiketa që kanë drejtu automjetin në anën e kundërt, pa shenjë komunikacioni ajo është e vërtetë, rrethi "Mujë Krasniqi" është në rregull edhe pse janë shumë afër shenjat, rrethi "Faruk Elezi" në drejtim të spitalit nuk ka shenjë kryqëzim të rrugës më përparësi kalimi dhe në qoftë se aty bëhet aksidenti ti fort mirë e di që dëmin e paguan Komuna. Janë bërë aksidente, njerëzit janë dënu pa pikë nevoje, rrethi "Nue Perlleshi" në drejtim të stacionit të policisë, Pejës ose Prishtinës nuk ka shenjë kryqëzim të rrugës më përparësi kalimi jo sot po më së paku që 10 takime unë jam këtu edhe ka qenë edhe Kryetari e kam thënë që nuk është në rregull, 1million 7,000€ janë dhënë për shesh të Klinës, jam tu i'u drejtu Komunës dhe jo ty, nuk je përgjegjës ti për shenja po është drejtoria e Inspektoriatit dhe e Shërbimeve Publike, që 4 vite kemi dal në vend të ngjarjes më drejtorin Iber Elezaj dhe më Petrit Bekaj, nuk është vendos kurgja, kjo është më e keqja e unë nuk jam tu fol për këtë qeverisje që ka filluar prej Janarit por jam tu fol edhe për qeverisjet e kalume, edhe ma herët që kjo qeverisje e ka marrë mandatin, këtu është problemi jam tu folë drejtëpërdrejt në profesion tem që sdi sa herë e kemi diskutu shumë mirë e ceke por nuk është tu u ba asgjë, faleminderit.

Zv. Kryesuesja znj.Marqe Selmanaj: Faleminderit shumë Josip, këto janë të gjetura që askush ma mirë se ti nuk i di sepse jeni ekspert i komunikacionit dhe instruktor gjithashtu kështu që na ndihmon patjetër që kjo që e the qëndron dhe jam e sigurt që bashkërisht do të bajmë së paku do të fillojmë ti bajm përmirësimet dhe jam e sigurtë që edhe kanë fillu, mirëpo tash çdo gjë e ka një kosto dhe të gjitha përnjehëre nuk mundemi mi ba por besojë që do t'ia dalim, faleminderit shumë. Urdhëro i nderum.

Z.Hoxhë Fitim Bojaj: Përshendetje Nënkyetare, Komandant, përshendetje për të gjithë, së pari shfrytëzoj rastin të gjithë besimtarëve të i'au uroj festën e Kurban Bajramit, dashtë Zoti të kemi vetëm gëzime e ditë të mira në këto ditë festë, po më pëlqen debati singrisht po e them, po më pelqen debati për arsyen se aty ku debatohet aty zhvillohet dhe punohet, aty ku kritikohet ka më pas suksese në të



ardhmen prandaj ju paneli mos na shihni neve që po i bajmë këto për inati, mirëpo që shembulli konkret po e dha tani, isha në një ceremoni mortore në varreza të qytetit dhe e përgëzoj drejtorinë e Arsimit që 2-3 herë po prezanton mbledhjen e KKSBB-së mirëpo kish më qenë e udhës që secili drejtor të prezantonte në mbledhje, nëse mendojmë që ne ofrojmë punë, nëse mendojmë që ne ofrojmë zgjidhje, mirëpo nëse ata mendojnë qe ne nuk ofrojmë zgjidhje atëhere ne largohemi, tërhiqemi, nuk marrim pjesë hiç, psh nesër është nata e Bajramit dhe plotë njerëz shkojnë e i përkujtojnë të afermit e vet le të del dhe të më thotë dikush a mundet më shku në varreza të qytetit, ndoshta arsyetimi kish më kanë që ska buxhet, Nënkyetare kisha pas dëshirë që këtë shqetësim nesër ju në bord më drejtorë kérku më shku në mëngjes më i pastru varrezat e qytetit që familjaret më pas mundësi më shku, është si kërkesë e jona që është shqetësim nga disa familje që i kanë anëtarët aty e kanë hap këtë si shqetësim. Kultura e një vendi janë edhe varrezat, faleminderit shumë.

Zv. Kryesuesja znj. Marqe Selmanaj: Faleminderit Hoxhë i nderum, unë shfrytëzoj rastin më i'u uru Bajramin të gjithë atyre që festojnë, e kisha mendu në fund të mbledhjes këtë urim, shëndet, begati në familjet e juaja. Është shqetësim më vend, se cila është mënyra që një Komunë mundet më adresu problemin dhe më zgjidh problemin në këtë mënyrë ose në këtë pikë të caktume nuk jam e sigurtë që muj më i'u dhanë përgjigje sepse nuk e di saktë se si dhe sa është i ndarë buxheti për më mujt më i'u dal në ndihmë qytetarëve sa i përket varrezave, e di që kanë fillu të ju ndihmojnë më rrëthoja mandej më raste kur vdesin etj por në këtë aspekt nuk mundem më dhanë një përgjigje të saktë dhe sigurisht që do ta përcjell shqetësimin tuaj, jam e sigurt që kjo që do ta përcjellim është një kohë shumë e shkurtë më mujt që na më kanë kaq feksibil dhe më mujt që nesër me reagu, por e imja është që kam mi njoftu e the shumë mirë që një kulturë e një populli shihet në varreza dhe ne bash aty çalojmë mirëpo si popull ndoshta edhe çdo popull që kalon në periudha si kemi kalu ne, nuk është që mujm më ba ku më dit sa, uroj shumë që të jetë një perspektivë e mirë edhe në këtë që e thatë ju, ju faleminderit shumë sepse më të vërtetë është shqetësuese.

Faleminderit shumë për intervenimin, nëse ka dikush tjetër të kjo pikë edhe ndoshta pak ju mbeta borxh Josipit, të siguria në komunikacion unë e kam ba më theks të veçantë sipas planit për shkolla, fëmijë dhe nxënës por unë kur e interpretova pikën e rendit të ditës ju thash që ka të bëjë më sigurinë e gjithë qytetarëve, mirëpo tu i ditë rastet në komunikacion që atakojnë më fëmijët dhe të vjetrit kjo është pse e kemi cekë si rend të ditës. Lirisht neve na ndihmoni kushdo që merr pjesë në debat.

Z.Hazir Tigani: Përvshendetje për të gjithë, është hera e parë që jam në këtë përbërje por nuk është hera e parë që kemi adresu kërkesa të stacioni i Policisë më theks të veçantë, të shkolla e mesme e ulët "Azem Bejta" në Grabanicë, nxënësit e kësaj shkolle ka shumë vite që kërkojnë, nuk e di a është adresu çështja këtu në Këshill por të Kryetari po, të drejtori i mëparshëm i DKA-së po dhe drejtori i tanishëm është i informum, por nga Policia kemi kérku që në mes ndrrimit të ketë një ose dy policë që ta menaxhojë situatën sepse komunikacioni aty, qarkullojnë pa leje të rinjë të ndryshëm dhe nxënësit rrezikohen sidomos në atë pjesën e udhëkryqit që kthehen nxënësit prej Dollovës dhe prej asaj pjesës andej për në shkollë, mandej është kérku prej Kuvendit Komunal që të ndërtohet një trotuar për këmbësor për nxënës më theks të veçantë për ta, kemi nxënës që edhe e kanë humbur jetën, jeni në dijeni, kemi edhe të tillë që kanë qenë përpara të dëmtum dhe ky vit shkoj si çdo vit tjetër, kisha më kérku që prej Shtatorit të kemi në mes të ndrrimit prej orës 12:00 deri në orën 13:00 dhe në mëngjes prej orës 7:00 deri në orën 8:00 të ketë patrullime nga ana e policisë në mënyrë që mos të jenë nxënësit e rrezikum. Një pyetje tjetër për drejtorin e DKA-së, meqënëse unë jam i rizgjedhur Kryetar i Këshillit



drejtues i prindërve dhe jam sekretar i përgjithshëm dhe pas zgjedhjes sime, kam bisedu më drejtorinë pasi kam ba disa vizita në shkolla dhe e kam pa që në shkollën e mesme të ulët "Ismet Rraci" nuk ka portë hyrëse, në fakt është porta hyrëse por nuk menaxhohet si duhet, dhe aty kam kérku nga drejtori i DKA-së të ndërtohet një portë ku do të hyjnë vetëm nxënësit dhe jo edhe prindërit e qytetarët e shumtë më vetura e këmbësorë të ndryshëm pastaj edhe të shkolla e mesme "Femi Agani" është një situatë e tillë, thjeshtë në qytet nuk ka porta hyrëse dhe mund të hyjë e të dalë kush do dhe kështu në këtë mënyrë mund të rezikohen nxënësit dhe personeli arsimor, pyetja për drejtorinë, çka keni ba dhe deri ku keni mujt më arrit? A do të realizohet deri në Shtator, a do të kem porta në shkollat "Ismet Rraci", "Femi Agani" dhe "Motrat Qiriazi" pasi që një e tillë egziston në shkollën e mesme "Luigj Gurakuqi", faleminderit.

Z.Qemajl Sejdija: Përshendetje për të gjithë, Nënkyetare, Komandant i Policisë.

Për pjesën e shqetësimit që e ngriti profesori i nderum, portat edhe në shkollën "Femi Agani" dhe në shkollën "Ismet Rraci", procedurat janë përfundu dhe në Shtator do të janë të kompletume, sa i përket pjesës së sigurisë kemi pas debat, unë kam e kam ba kérkesë edhe në bord këtë shqetësim sa i përket pjesës së pengesave, se na duhem më ba një formë tjetër të pengesave, jo më pas vija se po e shohim që më vija nuk po e ngadalësojnë shpejtësinë dhe se po kemi rrezik prapë, një model i tillë që mendojë që është i mirë është të pjesa e Prishtinës kur ato janë mbi asfalltë, që e ka një vlerë më të lartë por jo për më pengu shumë, e kam kérku më ba në atë formë se mendojë është më pak rrezik, sa i përket pjesës së sigurisë ato shkolla të cilat skanë qenë të mbuluara më kamera, në Shtator të gjitha kanë mbulim më kamerë dhe sa i përket kérkesës që e pati Kryetari i këshillit të prindërve, në shkollën "Azem Bejta" në fshatin Grabanicë, këtë shqetësim e kam pas edhe prej banorëve të fshatit, sa i përket pjesës së shpejtësisë po mendojë që më rregullore dhe më ato pengesa që i qesim në rrugë, besojë e redukojmë atë pjesë. Nuk e di sa është e mundshme të pjesa e Policisë dhe nuk e di sa kanë kapacitet për atë pjesë. Ne e kemi një plan të veprimit të DKA-së, është pastrimi i shkollave edhe pse kemi përfundu si vit por jemi tu e ba për shkak të fillimit të vitit të ri shkollor, e kemi rregullimin e nyjeve sanitare që janë defekt, ngjyrosjen e mureve sipas nevojave të shkollave, rregullimin e inventarit ku është dëmtu edhe rregullimin e rrethojave dhe lyerjen e shkollave. Ky është plani i drejtorisë së arsimit deri në fillim të vitit të ri në Shtator, faleminderit.

Zv. Kryesuesja znj. Marqe Selmanaj: Kisha dasht më u ndërlidh prapë, kur lyp sigurinë e hyrjes të porta e ceke shumë mirë, DKA-ja sigurisht që është tu u mundu dhe e shoh vazhdimisht që janë tu i punu rrethojat e shkollës, mirëpo sa i përket menaxhimit të hyrjes në shkollë të prindërve, nxënësve, të gjithëve në një drejtim, unë jam shumë e sigurt që kjo duhet të mbetet në menaxhim të shkollës dhe drejtorëve të shkollave, sepse prej përvjoes është shumë problematike më i ndalu prindërit më hy në objektin e shkollës, për shumë arsyesh kështu që në oborr kaniherë osht shumë vështirë më i ndalu së të gjithë i kanë fëmijët aty, kanë dëshirë të marrin pjesë deri sa t'i sistemojnë, drejtori sigurisht do të mërret më drejtorët e shkollave dhe do ta rregullojë këtë çështje.

Z.Qemajl Sejdija: Kisha dashtë më shtu pak në këtë pjesën e sigurisë, se në hyrje të shkollës "Ismet Rraci" do të ketë kujdes, do të këtë vendosje të një sigurimi i cili do t'a kontrolloj gjëndjen e hyrjeve dhe daljeve, pjesa e portës nuk do të jetë e hapur siç ka qenë deri tanë por do të kontrollohet për shkak se na e dimë se veturat po hyjnë në oborrin e shkollës dhe siguria e nxënësve po rrezikohet, për ata ne e kemi



paraparë këtë pjesë dhe prej Shtatorit nuk do të ketë hyrje në objektet shkollore, do të ketë kujdes të shtuar dhe në hyrje do të ketë një sigurim dhe do të ketë kujdes sa i përket pjesës që e diskutuan, faleminderit shumë.

Zv. Kryesuesja znj. Marqe Selmanaj: Nëse ka edhe dikush tjeter diçka, a po të kalojmë në pikën tjetër të rëndit të ditës, pika tjetër e rëndit të ditës ka prapë të baj më nxënës.

Pika e dytë e rëndit të ditës është: Sensibilizimi i të rinjëve për mbrojtje të dukurive negative që dëmtojnë shëndetin, zhvillimin e tyre, rreziku i përdorimit të narkotikëve më theks të veçantë në shkollat fillore dhe të mesme, informimi i nxënësve për dhënien e ndihmës së parë dhe gjithë ato që shkojnë në dobi të nxënësve duke e mbrojtur shëndetin e tyre, ky është si objektiv që ne e kemi paraparë dhe është e paraparë thuajse në çdo vit shkollor, dhashtë Zoti të mos kemi raste të tilla që dëmtojnë shëndetin, imazhin dhe gjithë atë që prindërit tanë e shkollat mundohen ta ndërtojnë më vite dhe mendojë që si Komunë nuk qendrojmë keq, mirëpo kjo nuk na bën që ne të jemi pasiv dhe të presim deri sa të ndodhë rasti, për këtë arsy si objektiv faktikisht e tregova ndërsa si aktivitet kemi paraparë patrulla të rregullta të Policisë gjatë orarit: fillimit dhe mbarimit të procesit mësimor, pastaj vendosja e barrierave, mbajtja e ligjëratave në shkolla të Komunës, nga ekspert të mjeksisë dhe specializimeve përkatëse sepse ne e dimë që mësimdhënësitë i kanë lendët e veta mësimore, por kur ofrohet diçka shtesë nga ekspertet e caktuar, mendoj që këta fëmijë do ta kenë më të lehtë formën sensibilizuese dhe besojë shumë që këto dukuri do të janë të pakta dhe uroj shumë që të mos janë fare, nëse dikush dëshiron ta ketë fjalën.

Z.Hoxhë Fitim Bojaj: po hapim debat zonja Nënkyetare, fëmija është dhurata më e madhe që ta jep Zoti dhe ajo nuk kompenzohet më asgjë, prandaj e kemi amanet nga Zoti më e rujt, më eduku, më shkollu. Më të vërtetë të gjitha ato që i ceket janë këshilla me vend dhe porosi me vend dhe të gjithë duhet të angazhohemi sidomos të çështja e lendëve narkotike, Komandanti është prezent dhe është më shumë i informum por edhe ne kemi info që vijnë si të Kisha Katolike si të Bashkësia Islame, mirëpo dukuri shqetësuese është edhe drejtori i Arsimit këtu, fëmija nuk është siq ka qenë përparr fatkeqësish bota e internetit e ka ba të vetën dhe nuk po kontrollohen, ne kemi pas shumë raste që arsimtari ka thënë: unë ma në atë klasë nuk shkoj për arsy se unë du me majt vendin e punës se nuk ju lejojke edhe të klasa e tetë dhe e nënta të mbahet orë prandaj e kemi pa edhe plan programin që është ba siguria në shkolla, më ligjerata të ndryshme, ekspert të ndryshëm, policia, shoqatat joqeveritare, qeveritare, unë edhe atë ditë e kam thanë edhe sot po e them edhe bashkësit fetare të hyn në këtë grup dhe të punojnë në këtë drejtim.

Zv. Kryesuesja znj. Marqe Selmanaj: Faleminderit shumë, sigurisht që do ta marr fjalën Drejtori dhe Komandanti i Policisë, është temë shumë e ndjeshme por sa i përket involmimit të klerit nuk e di a është e rregullueshme më ligj por jam e sigurt që të dy bashkësit fetare, fëmijët pas procesit mësimor i frekuentojnë edhe kishën edhe xhaminë, pa dashtë më ndërlidhë më atë që jeni të mirëseardhur edhe në objektin arsimor, të unë personalisht po mendoj që më ndihmën tuaj të pakushtëzuar e keni mundësinë më dhanë në mënyrën më të mirë të mundshme sepse e di shumë mirë ndihmën e klerit tek fëmijët sidomos kur ajo është në mënyrën më pozitive që shkon në të mirën e familjes dhe shoqërisë, ju përgëzoj për përkushtimin për mundësinë për më ndihmu aty ku jeni e keni shumë, faleminderit.



Komandanti i Policisë z.Ragip Bytyqi: Sa i përket kësaj pike, një ndër strategjitet kryesore në parandalimin e kësaj dukurie është edhe luftimi i kësaj vepre penale ku në këtë vit kalendarik drejtoria e arsimit ka informacione që në 3 mujt e fundit e kemi organizu një plan operativ në bazë ditore, ku dy zyrtarë policor kanë qenë pothuajse në çdo shkollë brenda 8 orëve pune, në këtë plan e kemi përgaditë në bazë të informacioneve, informacionet kanë qenë shumë të ashpëra fillimisht kur janë marrë, ato informacione ne i kemi përpunu në bazë të atyre përpunimeve, kemi hartu plan operativ, kemi vepru edhe nuk ka dal në teren ashtu si ne jemi përgaditë, kështu që mjafton një rast më ndodhë, është shumë sepse hoxha veç e tha, kemi obligim moral, shpirtëror dhe ligjor por situata nuk është ashtu alarmante në popullatë, unë në të gjitha takimet raportoj për gjendjen e sigurisë edhe për informacion të juajin, prej fillimit të vitit deri më tani në komunën tonë janë 6 raste të iniciuara për blerjen e narkotikëve, në atë aspektin statistikor nuk janë shumë por kur e marrim në anën tjetër 6 raste janë shumë sepse janë 6 persona të involvuar dhe 6 persona mundën më infektu një varg dmth janë zingjir, prej 1 Janarit situata në zonën tonë të përgjithshme është e qetë, duke i marr për bazë 2 raste që kanë qenë raste më përmasa më të mëdhaja, i kemi pas fatkeqësisht 2 raste të vrasjeve, ne si polici e Kosovës i kemi marrë të gjitha veprimet më të gjitha organet dhe akterët që përfshihen në ato raste, pësonat e dyshuar janë arrestuar që në momentet e para të kryerjes së veprës edhe ata janë në vuajtje të denimit, akoma nuk janë denuar por janë në procedurë të gjykimit. 16 raste të vjedhjeve, i kemi 22 vjedhje të rënda, 11 raste dëmtim të pronave, 3 raste i kemi hyrje në sistemin kompjuterik, 3 raste rrezikim i sigurisë në punë, 4 raste të ndërtimave pa leje, 16 raste armë mbajtje, 2 raste janë përdorim të armës, 1 rast sulm ndaj personit zyrtar, 22 raste dhunë familjare, këtë vit kalendarik kemi rritje për 40% të këtyre rasteve, 6 raste posedim i narkotikëve, 3 raste falsifikim i parasë, 77 aksidente më dëme të vogla materiale, 2 raste vrasje, 2 raste tentim vrasjeje dhe 19 lëndime trupore, zbulueshmëria e këtyre veprave penale do të thotë në 2022 deri më tani janë 300 incidente të paraqitura në stacionin tonë për dallim nga viti 2021, janë 256, kemi ngritje të incidenteve mirëpo krahas ngritjes kemi rritje të zbulueshmërisë, zbulueshmëria e këtyre veprave penale prej datës 1 Janar deri më datën 1 Korrik 2022 është 85.3%. Është një statistikë relativist e kenaqëshme e zbulueshmerisë, dëshira jonë është për më zbulu 100% por 85.3% zbulueshmëria është një statistikë e kenaqëshme, deri më tani janë realizuar 1.215 patrullime më veturë, 2.166 pika kontrolli janë konfiskuar, 365 municion të kalibrit të ndryshëm, janë arrestuar 387 persona dhe janë lëshuar 5.416 gjoba të ndryshme në komunikacion. Kjo është në pika të shkurtër sa i përket situatës së incidenteve të paraqitura në 6 muajt e parë.

Zv. Kryesuesja znj. Marqe Selmanaj: Faleminderit Komandant, uroj që këto raste të janë sa më të rralla ose të mos ekzistojnë fare, 6 raste janë si numër shumë pak por që dinjë më ba dëm shumë të madh, nëse ka dikush tjeter diçka, po Don Agim.

Z.Agim Qerkinaj: Po ndërlidhna edhe unë më fjalët që tha Hoxha, sensibilizimi i të rinjëve nga dukuritë negative duhet të jetë një ndër prioritetet e drejtive të shkollave, të cilat pastaj më ekspertët dhe njerëzit profesionistë mund të investojnë në këtë çeshtje, të ngritet niveli që të mbrojnë vetën nga kjo shoqëri, pastaj të gjitha institucionet tjera qofshin ato edhe fetare, sigurisht që duhet të jepin kontributin e vet që të kemi një shoqëri sa ma të shëndoshë në këtë drejtim, statistikat që i dha Komandanti janë shqetësuese por urojmë të janë sa më të pakta tash e tutje.

Z.Hazir Tigani: Mendimi im është që lëndet zgjedhore, mund të mbajnë mësimdhënësit brenda shkollës, lënda mund të jetë parandalimi i dukurive negative-lendët narkotike, mund të mbahet një herë në javë



psh: sociologët, filozofët ose edhe psikologët dhe këta mund ta ligjerojnë këtë lëndë dhe në këtë mënyrë mund ta japid kontributin e tyre për t'i vetëdijesuar nxënësit pér t'i ikur kësaj dukurie që është shqetësuese pér shoqerinë tonë. Në anën tjetër mund të merret edhe një lëndë tjetër psh: etika e edukimit moral, edhe kjo mund të futet si lëndë e mësimit zgjedhor, dy lëndë qe kishin pér qëllim që nxënësit të janë të vetëdijeshëm dhe të dinë se cilat janë dukuritë negative dhe çdo gjë që mund t'i pret do të thotë përpos kontributit që mund të jepni ju përmes organizatave, mund të shkojmë edhe në këtë formë, mësimdhënësit që përzgjedhin këto dy lëndë që janë shumë domethënëse dhe që kishin më dhanë kontribut të jashtëzakonshëm në këtë drejtim.

Zv. Kryesuesja znj. Marqe Selmanaj: Faleminderit profesor, ne këtu e kemi edhe drejtorinë e arsimit po fillimi shi do të them se orët janë të planifikuar nga ministria e arsimit sa i përket kurrikulës shkollorë dhe janë të parapara pér çdo klasë. Në kuadër të landës Edukatë Qytetare, ka shumë tema që flitet edhe pér dukuritë negative por ka edhe lëndë të tjera ku flitet pér sensibilizimin e të rinjëve ndaj sëmundjeve të ndryshme infektive, formave të ndryshme mandej të droges, alkoolit, duhanit e të gjitha dukurive që e dëmtojnë shëndetin e fëmijëve, pra shkollës nuk i mungonë aspak aspekti i lëndëve mësimore, sdo të kishte qenë keq të gjejmë ekspert që ata të na ndihmojnë në cilëndo fushë, sa i përket kësaj që e thamë, shqetësimi është i përgjithëshëm por sidomos ata që punojnë në arsim, e dinë shumë mirë gjendjen. Faleminderit shumë.

Z.Qemajl Sejdija: Faleminderit prof, tek ne mungon bashkëpunimi në përgjithësi, tu fillu nga drejtori i shkollës, tek ne ka shumë ankesa që adresohen në mënyrë verbale por kur vjen puna dhe i themi që merre një ankesë dhe shkruaje, ti duhesh më pas një diçka që ne më vepru në atë pjesë dhe këtu ne kemi ngecje e në këtë pjesë kemi shumë ankesa që nuk kemi ligjerata sa duhet, tek pjesa e lëndeve zgjedhore e din fort mirë që ato janë të përcaktuara nga ministria e arsimit dhe drejtoria e arsimit në komunën e Klinës nuk ka të drejtë ti përzgjedhë lëndët, këtu i patëm disa kërkesa pér ligjime dhe unë e di që çdo ligjeratë është e mirë, që sjellë diçka të mirë edhe tek pjesa e përfaqësuesve fetar që kemi këtu, kjo pjesë duhet të rregullohet nga ministria e arsimit sepse ne nuk jemi kundër askujt që mund të vetëdijësojë nxënësit e komunës sonë, problemi tek ne në shumicën e rasteve është që nuk jemi siguria vetë, kur e them këtë siguria vetë kur e shohim një dukuri sido që të jetë, para shkolle ose te nxënësit është mirë më njoftu dhe në momentin që ne nuk i njoftojmë këto dukuri, këto shkojnë tu u zhvillu, unë shohë edhe X raste tjera që po dal pak jashtë teme, unë shoh kur vjen prindi edhe më thotë mungon mësimdhënësi, nuk vjen në klasë, nuk mban orë mësimi, kur e pyes se kush është, më thotë: jo se smuj ashtu mfal, kjo pjesa që e the ti është shumë e qellueshme sikur të kishin marr ministria e arsimit, ti je pjesë e këshillit të prindërve besojë që ka edhe përfaqësues të ministrisë dhe është mirë më ngritë si çështje, por ne është mirë si qytetarë të gjithë të vetëdijësohemi si banorë të Klinës që kur e shohim një dukuri të tillë jashtë, duhet më e lajmëru, ne kemi shumë ligje, rregullore, të gjitha i kemi por kur vjen puna të zbatimi i tyre, ne nuk vazhdojmë deri në fund, ne e mbajmë një ligjeratë që jam pro ligjëratave por është mirë që ne prindërit më u kujdes pér fëmijët tanë, më përcjellë në çdo hap. Pra këto janë pjesë që ne duhet ta kemi kujdesin e vazhdueshëm, ne kemi kontakt të vazhdueshëm më Policinë dhe kanë pasë kontrolla të vazhdueshme nepër të gjitha shkollat, unë kam dëgju shumë fjalë dhe kemi mbajtë takime por rezultatet nuk na kanë tregu do të thotë atë pjesën e shqetësimit që e kanë pasë në diskutime njerëzit dhe shqyr Zotit, që nuk e kemi atë rezultat që unë e kam ndëgju. Unë si drejtor i drejtorisë së arsimit në Klinë, në bashkëpunim më drejtorat e shkollave ju kam kërkua që nëse e verejnjë një shqetësim duhet të deklarojnë, në momentin që i deklarojnë rastet atëhere e adresojmë problemin



dhe kështu kemi rezultate, të falenderojë për pjesën që the tek lëndët zgjedhore, mendojë që është shumë e qëlluar por jemi duarlidhun sepse aty vendosë ministria e arsimit dhe duhet me e ngritë si çështje në nivel qëndror të këshillit të prindërve dhe besojë që sa i përket pjesës së drejtorisë së arsimit skemi asgjë kundër.

Z.Hazir Tigani: Më rekomandim tonin në Prishtinë, janë shpallur konkurset për këto dy lëndë dhe kuadri që do të pranohen janë: sociologë, filozofë dhe psikolog tek ne, po shifet që skeni informacion por kemi kohë deri në Shtator.

Z.Qemajl Sejdija: Prof tek lëndet që ti i specifikove, psikologët kanë qenë gjithmonë dmth tek lëndët e sigurisë që i kërkove është fjala, të pjesës së sigurisë ne duhem mi pasë akterë taman të fushës për ata ne kemi pasë komunikim më Policinë e Kosovës, se ata janë në njohuri më këtë pjesë dhe ballafaqohen më këtë pjesë. Unë i kam pa lëndët zgjedhore që i ka shpallur drejtoria e arsimit në komunën e Prishtinës, por aty nuk janë të pranishme pjesët e lëndëve që ti i citove këtu.

Zv. Kryesuesja znj. Marqe Selmanaj: Kalojmë tek pika e fundit e rëndit të ditës, të ndryshme, nuk kemi specifikuar ndonjë pikë dhe kemi mundësi të diskutojmë gjithçka që është e dobishme dmth në dobi të sigurisë së Komunës sonë, urdhëro Elmi faleminderit.

Z.Elmi Zenunaj: Përshendetje për të pranishmit, unë deshta një shqetësim më ngritë, kom pasë një aktivitet privat në lagjen Jashanica e epërme ku më investimin e Komunës, një prokë që vazhdon nga lagjia Halitaj e vjen nga lumi Klina knej është krijuar një moqdeal infektues, më fajin e Komunës që është mirë dikush më shku më pa atë zonë se çka ka ndodhë në atë pjesë, kanë investuar në kanalizime që janë bartë buzë lumbit dhe aty shprazen në sipërfaqe, nga lagjia Avdijaj deri në lagjen Hoti, lartë janë kanale sipërfaqësore që mund të janë burim i infektimeve për fëmijë e gjithçka tjetër, ish kan mirë më ndërrmarrë diçka.

Zv. Kryesuesja znj. Marqe Selmanaj: Unë do ta përcjelli në drejtorinë përkatëse, nuk kam diçka informacion përkatës që mundem më të dhënë por do ta përcjelli, faleminderit shumë. Ka dikush diçka tjetër, Josip.

Z.Josip Dedaj: Zonja kryesuese meqënese nuk është Kryetari këtu, por i kam 3 pyetje që janë shumë të rëndësishme, mbi 40 biznese në qendrën zeztare të shkolla filllore "Motrat Qiriazi" këtë e kemi diskutu edhe më Komendantin, parkingu që është mbrapa qendrës zeztare ne bizneset, e kemi një problem të madh, aty njerëzit vijnë e i parkojnë kerret dhe ne bizneset nuk kemi ku më i parku, unë jam një ndërtatim paguesit më të rregulltë dhe nuk kam vend ku më parku kerrin, jemi ballafaqu sdi sa herë më fjalosje, më fyerje, disa here edhe më sharje, më herët pa u kan Komendant z. Bytyqi, ka qenë shenja ndalim parkingu, përpos lokaleve tash nuk ka shenjë, e ka hekë dikush dhe aty kush don e parkon e rrin gjithë ditën e ne bizneset që jemi tatim pagues të rregulltë nuk kemi ku më parku.

E dyta është, qito procesverbale që unë bukur moti jam i rregulltë edhe në takim më qytetarët, postohen nga faqja sociale e rrjetit komunal, nuk di qysh u kanë por takimi i fundit thotë: veç u mbajt takimi më qytetarët, zotëri Kryetari qka bisedon dhe nuk i tregon shqetësimet e qytetarëve, mendoj që duhet më kanë edhe shqetësimet tona në faqën e Komunës.

E treta, një pyetje për Kryetarin dhe për ty zonja Nënkryetare, për qka orari i takimit të KKSBB-së po



mbahet në orën 16:00, meqenëse unë jam anëtar i KKSBB-së qysh moti dhe nuk jam pagu asnjëherë, nëse nuk gaboj njëherë nuk e di për ju të tjerët, dhe tash mos është interes i, i Kryetarit besa edhe i Komendantit që më u marrë meditja mbas orës 16:00 e unë qe 12 vite sjam pagu, veç edhe një falenderim që më qëllim e kam lan në fund, më të vërtetë jam mirënjoës dhe e falenderojë përzemërsisht në emër të fshatit Dresnik dhe Dollc, që jam kryetar i KLSP, Policinë e Kosovës, Kforin Slloven dhe OSB-në, që së paku njëherë në javë kemi takime edhe më Policinë që është departamenti lokal për komunitete dhe më Kforin Slloven që kemi shumë kompromis të mirë për sigurinë e gjithë banorëve të fshatit Dollc dhe Dresnik si dhe OSB-në.

Zv.Kryesuesja znj. Marqe Selmanaj: Faleminderit shumë Josip, që je shumë aktiv dhe bënë shumë pyetje e ishalla merr edhe përgjigje, unë më ja nisë prej pyetjes së fundit, e bane pyetjen pse në ora 16:00, ti fillimisht the që je që sa vite anëtar i KKSBB-së e unë faktikisht jam tu u mundu më e zbatu atë plan që është bërë më heret se unë, nuk mundëm më nxjerrë rregullore të re dhe është e paraparë pasi ne të përfundojmë procesin e punës, orarin e punës prej orës 16:00 dhe pjesa tjetër është më sa e di unë se e kemi këtu edhe zyrtarin ligjor që i din punët e mëherëshme dhe procedurat, e di që puna e anëtarëve të KKSBB-së paguhet edhe një që më ta hekë ty dyshimin nëse paguhna unë ki me u pagu edhe ti, nese nuk paguhna unë nuk paguhesh as ti këtë t'a siguroj, por kësaj here kur e kemi punu planin nëse e keni përcjellë, e kemi paraparë edhe buxhetin që është miratu në kuvendin Komunal dhe është e pamundur mos më u pagu procesverbali, nuk prezantohet i gjithë procesverbali në faqen e komunës, komuna thjeshtë e prezanton që është mbajt, niveli qendoror sot na e ka kërku procesverbalin e takimeve që i kemi mbajt, ne e kemi mbajtë vetëm një takim për shkak se ashtu kanë qenë rrethanat, jemi aktivizu vonë por na u është kërku në detaje çdo punë që është bërë në atë takim dhe këtë takim koordinatorene qe e kemi, e kemi të çasëshme ndaj kërkësave të tyre, atje janë ato që prezantohen fjalë për fjalë ashtu qysh ke folë ti edhe unë, por jo në faqe të komunës se nuk ka mundësi procesverbali me u qit si shpallje, çështja e parkingjeve lyp diskutim, nuk jam kompetente sikur isha e sigurt në këto dy përgjigjet që t'i dhash, duhet më shiqu se ku janë problemet, mirë është më kanë i durushëm edhe ti së problemet mujnë edhe më ardh, ishalla nuk vinë por tu i pa edhe specifikat e Komunës, parkingu është problem shumë i madh e kuptoj si shqetësim dhe uroj që të zgjidhet, do ta adresojë problemin dhe se kush do ta bëj zgjidhjen shpresojë që të bëhet sa ma shpejtë, e rrugën e Dresnikut e diskutova, është mirë që kur e thu e cakton ni datë, është mirë më ja dal por në një qeverisje lokale dhe në një punë më dinamikë se qysh e ka Kryetari, është vështirë më dalë saktë në një datë të caktume. Por ju jeni të gjithë të përgjegjshëm, unë të thashë të përgëzojë për debatet që i bënë por duhesh më qenë pak edhe i kuptueshëm që Kryetari është mundu më ba më të mirën për të gjithë qytetarët pa dallim, edhe duke qenë i tillë unë sot kam marrë guximin më qenë këtu se perndryshe më hy disa rrugëve nuk është e lehtë, jam shumë e sigurt se nëse Kryetari e premton ka më e realizu, duhet të jemi edhe pak të durueshëm sepse janë rrethanat që i përmenda më herët por besojë në atë që e ka thanë ka më ja dal, a ka dikush diçka tjetër.

Z.Josip Dedaj: Unë jam Josip Dedaj që e kam pas mikun ma të mirë, unë sjam tu fol për Kryetar, jam tu fol për Komunën në përgjithësi, tash nëse Kryetari e merr barrën ti je e dyta por ti 4 vite më herët nuk je kanë, prej qetij kuvendi më të gjitha votat është miratu buxheti për fshatin Dresnik 65.000€ në 2018-në, prioritet i Komunës ka qenë rruga e fshatit Dresnik, në 2019-në më



15 Mars më fillu punën, tash zonja Nënkyetare nëse mundesh mem thanë duhesh më kan i durueshëm, unë më gjithë banorët e fshatit Dresnik mujm më ardhë më u ulë të Komuna së paku 300 persona, nese ti mthu që duhna më kanë i durueshem për 6 muj, unë nuk kam më folë ma, por Kryetari më ka premtu për rrugën e Dresnikut se kemi fol e kemi ba projekte, unë po deklarohem në emër të fshatit Dresnik që fshati Dresnik është jetim, nuk ka Komunë 5 vite fjalë 5 vite premtive.

Zv. Kryesuesja znj. Marqe Selmanaj: Josip, na e tham më herët që vendi i punës në këtë rast jemi për Siguri në Komunë si bashkësi, nuk po e përfaqësojë në këtë rast politikën por një qytetar që dojmë më punu bashkë, kur them durimin lum kush e ka durimin edhe ju edhe ne edhe krejt por kur e permende Dresnikun ndoshta unë sjam shumë e sigurt por ti e din që disa specifika nuk i ke përmend në lidhje më rrugën për qka ka ngecë problemi deri në periudhë të caktume, ti e din shumë mirë por ato i diskutojmë ma vonë, nuk është që nuk e di rastin edhe pse nuk kam qenë 4 vite më parë por janë tema që mu më interesojnë shumë e sa mujm më i zgjidhë na ndihmoftë Zoti.

Unë e pata një njoftim prej koordinatores, po e shoh që pjesa më e madhe dulen, duhna më thanë për këta që kanë mbetë, Josipi e ngriti më vend çështjen e pagesës por Josip pagesa nuk bëhet pa e pru konfirmimin e bankës dhe kopjen e letërnjoftimit, vitin e kalum nuk ka qenë dhe duhet më qenë të këtij viti, i orientoni tek koordinatorja përndryshe nuk ka mundësi më u ba pagesa.


Nëse dikush nuk ka diçka më shtu.

Z.Josip Dedaj: Për pagesat e mëherëshme ?

Zv. Kryesuesja znj. Marqe Selmanaj: Pagesat e mëherëshme nuk dha llogari më the që nuk jam kanë para 4 viteve kështu që nuk merrna.

Josip jam shumë e bindur që ti je shumë ma konstruktiv se sa që flet dhe ne kuptohemi shumë mirë dhe kjo që e diskuton i bënë dobi edhe komunikimit se përndryshe sikur të ishim të gjithë të heshtur nuk ish kanë interesant ky takim, por nuk do të jetë interesant nese vetëm marrim ide dhe nuk i zbatojmë, jam idh胎 e asaj që thuhet më ecë aq sa unë kam mundësi bashkërisht kuptohet, këtu i gjithë motorri i gjithë kësaj është Kryetari më stafin e tij për këtë që flitet këtu se për mundësitet e tjera janë njerëzit kompetent, unë këto çështje që i ngritet dhe që i kam evidentu, do të mundohem që disa ndoshta shpejt, disa më ngadalë e disa ishalla si harrojmë por bashkërisht të ja kujtojmë njëri tjetrit. Nëse dikush nuk ka diqka më shtu, ju falenderojë shumë për kohën që e ndatë e shihemi në takimin e ardhshëm dhe shëndet mbi të gjitha.

Procesmbajtësi,  
Orgeta Sylaj



Zv.Kryesuesja  
Marqe Selmanaj



